



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“PRODHIM BIMOR”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

K-H6-III-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

²Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja	4
Niveli	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
Kompetenca të përgjithshme.....	5
H6-08-III-0048-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në prodhim bimor.....	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	6
Kritere vlerësimi	6
H6-08-III-0049-24 Kushtet mjedisore për prodhimin bimor.....	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	7
Kritere vlerësimi	7
H6-08-III-0050-24 Teknologjia e prodhimit bimor.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	9
Kritere vlerësimi	9
H6-08-III-0051-24 Vjelja e perimeve dhe bimëve të arave.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	11
Kritere vlerësimi	11
H6-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	11
Kritere vlerësimi	12
H6-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	12
Kritere vlerësimi	12
	2

H6-08-III-0047-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit.....	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	13
Kriteret e vlerësimit	13
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:.....	14
Modalitetet e vlerësimit	14
Informacion shtesë	15
SHËNIM	15

Emërtimi i kualifikimit	“Prodhim bimor”			Kodi K-H6-III-24
	Kohëzgjatja	1500 orë nocionale	Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK,	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Prodhim bimor”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të mundësojë punësimin në veprimtari profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me prodhimin bimor, sipas kërkesave të tregut si dhe zhvillimin e personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Prodhim bimor” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: - kanë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Prodhim bimor”, III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Suplementin përkatës, që përkon me nivelin e punonjësit të kualifikuar në këtë fushë profesionale të tregut të punës. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut për t’u punësuar në drejtim prodhim bimor: në ndërmarrje publike ose biznese private për prodhim bimor; si i vetëpunësuar në veprimtari që lidhen me prodhimin bimor. Në përfundim të këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H6-III-19			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Prodhim bimor”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
8. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara;
10. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;

H6-08-III-0048-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në prodhim bimor

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë sektorët/nënsektorët e bujqësisë sipas karakteristikave të tyre;
2. Të përshkruajë zhvillimet në fushën e kultivimit të perimeve dhe bimëve të arave;
3. Të përshkruajë mënyrat e planifikimit periodik të punës;
4. Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
5. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, sipas funksionit;
6. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve;
7. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës;
8. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të higjienës në vendin e punës;

9. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të burimeve njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse;
10. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të kohës dhe radhës së punës;
11. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit me eprorët dhe specialistë të tjerë;
12. Të përshkruajë mënyrat e raportimit tek eprori;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë planifikimin dhe organizimin e punës në fermë;
2. Të menaxhojë burimet e nevojshme në fermë;
3. Të dokumentojë dhe raportojë për realizimin e detyrave;

Kritere vlerësimi

- Kryen planifikimin dhe organizimin e një ferme bujqësore, sipas parimeve;
- Kryen menaxhimin dhe monitorimin e një ferme bujqësore, sipas parimeve;
- Organizon në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Përcakton detyrat dhe prioritetet e një plani prodhimi në përputhje me objektivat;
- Zbaton rregullat e higjienës së vendit të punës, sipas standardeve;
- Planifikon kohën dhe radhën e punës, sipas teknologjive të kultivimit;
- Planifikon mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas proceseve të punës dhe funksionit të tyre;
- Përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas proceseve të punës dhe funksionit të tyre;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve të përdorimit;
- Kryen pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës, sipas procedurave;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Koordinon bashkëpunimin me eprorët dhe specialistë të tjerë të bujqësisë, sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse;
- Raporton në mënyrë periodike për realizimin e detyrave, sipas formateve përkatëse;

H6-08-III-0049-24 Kushtet mjedisore për prodhimin bimor

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë ndikimin e kushteve klimatike në kultivimin e perimeve dhe bimëve të arave;
2. Të shpjegojë veprimin e faktorëve ekologjikë (klimatikë, tokësorë dhe ujorë) në rritjen e bimëve;

3. Të përshkruajë teknologjinë digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave agrometeorologjikë;
4. Të përshkruajë masat mbrojtëse ndaj dukurive ekstreme klimatike në kultivimin e perimeve dhe bimëve të arave;
5. Të shpjegojë llojet e tokave sipas karakteristikave dhe cilësive fiziko – kimike të tyre;
6. Të përshkruajë mënyrat e marrjes së mostrave të tokës dhe teknikat e mostrimit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e krahasimit të rezultateve të analizave me standardet përkatëse;
8. Të shpjegojë parimet bazë të kullimit dhe format e kullimit të tokave;
9. Të përshkruajë sistemet e ujitjes së bimëve;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të vlerësojë kushtet klimatike për kultivimin e kulturave bujqësore;
2. Të vlerësojë kushtet tokësore dhe ujore për kultivimin e kulturave bujqësore;

Kritere vlerësimi

- Përzgjedh instrumentet matëse dhe regjistruese sipas parametrave klimatikë;
- Kryen matje dhe regjistrim digjital/analog të parametrave klimatikë, sipas procedurave;
- Krahason të dhënat e parametrave klimatik me kërkesat e perimeve dhe bimëve të arave për të vlerësuar kushtet e përshtatshme për kultivim;
- Analizon llojet e tokave, sipas karakteristikave të tyre;
- Merr mostrën e tokës për analiza fiziko – kimike, sipas procedurave përkatëse;
- Krahason të dhënat e laboratorit mbi cilësitë fiziko - kimike të tokës, sipas kërkesave të perimeve dhe bimëve të arave;
- Krahason faktorët hidrologjikë (reshjet, rrjedhjet, infiltrimi, evapotranspirimi) që ndikojnë në kultivimin e perimeve dhe bimëve të arave, sipas kërkesave të tyre;
- Ndërton një sistem kullimi, sipas standardeve
- Sistemon tokën, sipas procedurës;
- Ndërton një sistem ujitje, sipas llojit të kulturave.
- Merr masa mbrojtëse ndaj dukurive ekstreme klimatike (thatësi, përmbytje, ngrica, breshër, zjarre etj.) në kultivimin e perimeve dhe bimëve të arave.

H6-08-III-0050-24 Teknologjia e prodhimit bimor

Rezultatet e të nxënit në njohuri

Perimet

1. Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të kultivimit të perimeve;
2. Të klasifikojë perimet sipas kërkesave ndaj faktorëve klimatiko-tokësorë;
3. Të përshkruajë llojet e perimeve sipas teknologjive të kultivimit të tyre;
4. Të shpjegojë mënyrat e shtimit të fidanëve të perimeve;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së farave të perimeve;
6. Të përshkruajë teknologjitë e prodhimit të fidanëve të perimeve;
7. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat për përgatitjen e farishtes për prodhimin e fidanëve perimorë;

8. Të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e shartimit të perimeve;
9. Të përshkruajë llojet dhe rëndësinë e kryerjes së shërbimeve agroteknike në farishte;
10. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e shkëljes dhe standardizimit;
11. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e ambalazhimit, etiketimit dhe transportit të sigurt të fidanëve;
12. Të për zgjedhë kultivarët sipas kërkesës së tregut;
13. Të përshkruajë skemat e qarkullimit bujqësor të perimeve;
14. Të përshkruajë llojet dhe teknikat e kompostimit të mbetjeve organike;
15. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat për plehërimin bazë të tokës me plehra organike dhe minerale;
16. Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së tokës për mbjelljen e perimeve;
17. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e mbjelljes me farë dhe fidanë sipas standardeve;
18. Të përshkruajë përdorimin e mjetet dhe mënyrat e kontrollit digjital të parametrave mikroklimatikë në mjediset e mbrojtura;
19. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e automatizuara të ujitjes së perimeve;
20. Të përshkruajë teknikat e kontrollit të mbirjes së farës/zënies së fidanëve dhe zëvendësimit të bimëve;
21. Të përshkruajë sistemin mbështetës sipas llojit të kulturave dhe teknikat e lidhjes së bimëve;
22. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e kryerjes së punimeve plotësuese të tokës;
23. Të përshkruajë plehërimin plotësues dhe atë gjethor me plehra organike dhe minerale;
24. Të përshkruajë teknikat që përdoren për krasitjen e gjelbër të perimeve;
25. Të përshkruajë sëmundjet, dëmtuesit dhe barërat e egra të perimeve;
26. Të përshkruajë metodat, teknikat dhe preparatet për luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të egra;
27. Të shpjegojë teknologjitë e reja të kultivimit hidroponik;

Bimët e arave

28. Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të kultivimit të bimëve të arave;
29. Të shpjegojë rajonizimin e bimëve të arave dhe rëndësinë për kultivimin e tyre;
30. Të për zgjedhë kultivarët e përshtatshëm sipas kërkesës së tregut dhe qëllimit të përdorimit;
31. Të përshkruajë teknikat e për zgjedhjes së bimëve të arave sipas karakteristikave të klimës, tokës dhe ujit;
32. Të përshkruajë rëndësinë dhe skemat e qarkullimit bujqësor të bimëve të arave;
33. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të drithërave të hershme (grurit, thekrës, elbit, tërshërës, tritikaleve, tepës, okrës etj.);
34. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të drithërave të vona (misrit, orizit etj.);
35. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të bishtajoreve për kokërr (fasules, sojës, bathës, bizeles, qiqrës, thjerrëzës etj.);
36. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të patates;
37. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të bimëve industriale vajore e sheqerore (kikiriku, ricini, susami, panxhari i sheqerit etj.);
38. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të duhanit dhe manipulimit të tij;

39. të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të bimëve industriale fijore (pambuku, liri, kërpi etj.);
40. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit dhe manipulimit të bimëve mjekësore dhe aromatike;
41. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit dhe manipulimit të bimëve foragjere;
42. Të përshkruajë teknikat e kompostimit të mbetjeve organike;
43. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e plehërimit bazë të tokës me plehra organike dhe minerale;
44. Të përshkruajë përgatitjen e tokës për mbjelljen e bimëve të arave;
45. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat për mbjelljen e bimëve të arave, sipas llojit të kulturës dhe karakteristikave të tokës;
46. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat për mbjelljen e bimëve të arave me farë dhe fidanë;
47. Të përshkruajë teknikat e kontrollit të mbirjes së farës/zënies së fidanëve dhe teknikat e zëvendësimit të bimëve;
48. Të përshkruajë teknikat e rrallimit të bimëve të arave;
49. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e ujitjes së bimëve;
50. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e kryerjes së punimeve plotësuese të tokës;
51. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e plehërimit plotësues dhe gjethor me plehra organike dhe minerale;
52. Të përshkruajë llojet e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të egra;
53. Të përshkruajë metodat, teknikat dhe preparatet për luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të egra;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknologjinë e kultivimit të perimeve;
2. Të zbatojë teknologjinë e kultivimit të bimëve të arave;

Kritere vlerësimi

- Përzgjedh perimet dhe bimët e arave sipas kushteve klimatiko-tokësore të zonës;
- Përzgjedh perimet dhe bimët e arave sipas teknologjive të kultivimit dhe kërkesave të tregut;
- Përzgjedh farat e perimeve dhe bimëve të arave për kultivim, sipas kërkesa të tregut;
- Përgatit farishten për prodhimin e fidanëve të perimeve, sipas teknikave përkatëse;
- Sharton perimet sipas teknikave përkatëse;
- Kryen shërbimet agroteknike në farishte, sipas teknologjive;
- Përgatit fidanët për mbjellje, sipas teknikave përkatëse.
- Zbaton skemat e qarkullimit bujqësor të perimeve dhe bimëve të arave, sipas teknologjive të kultivimit;
- Kryen kompostimin e mbetjeve organike, sipas protokollit;
- Kryen plehërimin bazë të tokës me plehra organike dhe minerale, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen përgatitjen e tokës për mbjelljen e perimeve dhe bimëve të arave, sipas teknikave;

- Kryen mbjelljen e perimeve dhe bimëve të arave me farë dhe fidanë, sipas teknikave dhe llojit të kulturave;
- Kontrollon mbirjen e farës/zënien e fidanëve dhe zëvendësimin e bimëve, sipas standardit;
- Vendos sistemin mbështetës sipas llojit të kulturave bujqësore.
- Kryen punimet plotësuese të tokës, sipas teknikave dhe llojit të kulturës;
- Kryen plehërimin plotësues dhe atë gjethor me plehra organike dhe minerale, sipas kërkesave;
- Kryen krasitjen e gjelbër të perimeve, sipas teknikave;
- Kryen ujitjen e perimeve dhe bimëve të arave, sipas kërkesës;
- Kryen trajtimet fito-sanitare të sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të egra, sipas protokolleve;
- Kontrollon parametrat mikroklimatikë në mjediset e mbrojtura, sipas llojit të kulturës;
- Kryen kultivimin hidroponik të perimeve, sipas teknologjive përkatëse.
- Kryen rrallimin e bimëve të arave, sipas standardit;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të familjes solanore;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të familjes bostanore;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të familjes kryqore;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të familjes qepore;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të familjes kenopodiace;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të drithërave,
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të bishtajoreve
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të patates;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të bimëve industriale
- Zbaton teknologjitë e kultivimit dhe manipulimit të bimëve mjekësore dhe aromatike;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit dhe manipulimit të bimëve foragjere
- Kryen ambalazhimin, etiketimin dhe transportin e sigurt të fidanëve, sipas standardit;

H6-08-III-0051-24 Vjelja e perimeve dhe bimëve të arave

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të kohës së përshtatshme për vjelje;
2. Të përshkruajë stadet e pjekjes sipas kulturave;
3. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e vjeljes së prodhimit;
4. Të përshkruaj mënyrat e korrijës/kositjes së prodhimit;
5. Të përshkruajë teknikat e grumbullimit dhe transportit të prodhimit;
6. Të shpjegojë mënyrat e seleksionimit të prodhimit;
7. Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit;
8. Të shpjegojë kushtet e magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit;
9. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit digjital të parametrave për ruajtjen e prodhimit;
10. Të argumentojë rëndësinë e marrjes së masave mbrojtëse ndaj dëmtuesve të prodhimit në ruajtje;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e vjeljes;
2. Të kryejë seleksionimin, ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit;
3. Të monitorojë kushtet e magazinimit;

Kritere vlerësimi

- Përcakton kohën e përshtatshme për vjelje sipas llojit të kulturës dhe destinacionit;
- Monitoron stadet e pjekjes sipas kulturave dhe destinacionit;
- Kryen vjeljen e prodhimit sipas teknikave përkatëse;
- Kryen korrjen/kositjen e prodhimit sipas llojit të kulturës;
- Grumbullon prodhimet e perimeve/bimëve të arrave sipas teknikave përkatëse;
- Transporton prodhimet e perimeve/bimëve të arrave sipas standardeve;
- Kryen pastrimin dhe seleksionimin e prodhimit sipas standardeve;
- Ambalazhon dhe etiketon prodhimin sipas standardeve;
- Monitoron kushtet e magazinimit dhe të ruajtjes së prodhimit sipas standardeve;
- Kontrollon në mënyrë digjitale/analoge parametrat mikroklimatikë për ruajtjen e prodhimit, sipas standardeve;
- Zbaton masat mbrojtëse ndaj dëmtuesve të prodhimit në ruajtje sipas protokolleve;

H6-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere**Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të përshkruajë parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionin në fushën e bujqësisë;
2. Të shpjegojë format dhe mënyrat e hartimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
3. Të përshkruajë mënyrat e hartimit të grafikut të punës;
4. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat;
5. Të argumentojë rëndësinë e informimit për çmimet e tregut të inputeve bujqësore;
6. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostove të inputeve bujqësore dhe prodhimit;
7. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktet që do të ofrojnë;
8. Të përshkruajë të ardhurat dhe shpenzimet në bujqësi;
9. Të përshkruajë llojet e institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
10. Të shpjegojë teknikat e marketingut për prodhimin bujqësor;
11. Të përshkruajë mënyrat e analizimit të vetvetes;
12. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
13. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin e bujqësisë;
14. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
15. Të argumentojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita;
16. Të përshkruajë llojet e trajnimeve dhe kurseve profesionale.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë detyra administrative dhe tregtare;

2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të zhvillohet profesionalisht;

Kritere vlerësimi

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës;
- Plotëson planin e punës në përputhje me detyrën e dhënë;
- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike sipas rregullave;
- Zbaton grafikun e punës, sipas proceseve;
- Kryen blerjen e mjeteve, materialeve, dhe pajisjeve të nevojshme sipas nevojës;
- Zbaton teknikat e marketingut për prodhimet bimore;
- Plotëson dokumentacionin për bashkëpunimet me institucionet financiare dhe shërbimet e tyre;
- Përgatit oferta për produktet referuar çmimeve aktuale të tregut;
- Regjistron të dhënat e faturave të shitjes dhe marrjes së porositve sipas kërkesës;
- Llogarit çmimin përfundimtar për prodhimet sipas rregullave;
- Merr informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e inputeve bujqësore;
- Kryen vazhdimisht trajnime për zhvillimin profesional dhe të karrierës;
- Merr pjesë vazhdimisht në panairë dhe ekspozita në fushën e bujqësisë;
- Përdor teknologjinë bashkëkohore për proceset e punës në bujqësi, sipas rregullave;
- Informon në kohë bashkëpunëtorët për zbatimin e teknikave të reja në bujqësi;

H6-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e marrjes/dhënies së informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë metodat e komunikimit efektiv;
3. Të argumentojë zbatimin e parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
5. Të shpjegojë kodin e etikës profesionale;
6. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
7. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit me eprorët dhe kolegët;
8. Të shpjegojë përdorimin e TIK në komunikimin me të tjerët;
9. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
10. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës;
3. Të zbatojë terminologjinë profesionale të prodhimit bimor;

Kritere vlerësimi

- Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejtat e ditës;
- Zbaton parimet e punës në grup;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Zbaton teknikat e komunikimit për të arritur një komunikim efektiv;
- Zbaton kodin e etikës në mënyrë korrekte;
- Zbaton teknikat për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët sipas rregullores së brendshme;
- Përdor saktë terminologjinë profesionale
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

H6-08-III-0047-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
2. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ekologjike;
3. Të përshkruajë masat e sigurisë në punë;
4. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes personale dhe kolektive;
5. Të shpjegojë mënyrën e asgjësimit të produkteve të dëmshme;
6. Të përshkruajë zbatimin e sinjalistikës në mjediset e punës;
7. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të planit të evakuimit në raste emergjence;
8. Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
9. Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të mjeteve të ndihmës së parë;
10. Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
11. Të përshkruajë mënyrën e raportimit sipas rastit të personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
12. Të përshkruajë mënyrën e grumbullimit, largimit, përpunimit dhe përdorimit të përshtatshëm të mbetjeve në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;
13. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
14. Të përshkruajë mënyrën e menaxhimit të mbetjeve kimike të përdorura në proceset e punës;
15. Të përshkruajë përdorimin në mënyrë racionale të burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm;
16. Të shpjegojë mënyrën e zbatimit të protokolleve në raste të ngjarjeve ekstreme;
17. Të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë standardet e sigurimit teknik në punë;
2. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit;
3. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionit në fuqi për sigurimin teknik;
- Zbaton rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ekologjike;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik, sipas manualeve;
- Raporton sipas rastit te personat përgjegjës për mos funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik;
- Përdor pajisjet e MZSH sipas rregullave;
- Respekton sinjalistikën përkatëse sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton masat e sigurisë në punë sipas legjislacionit.
- Zbaton rregullat për parandalimin e aksidenteve sipas legjislacionit;
- Zbaton procedurat për dhënien e ndihmës së parë;
- Zbaton procedurat për evakuim në rast emergjencash;
- Zbaton protokollet e duhura në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme;
- Zbaton rregullat e higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;
- Zbaton procedurat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Përdor në mënyrë efikase burimet: ujë, energji, etj.;
- Zbaton procedurat për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes personale dhe kolektive sipas manualeve;
- Kryen asgjësimin e produkteve të dëmshme sipas protokolleve;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Kryen grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbetjeve të prodhimit në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në prodhim bimor	20	H6-08-III-0048-24
2	Kushtet mjedisore për prodhimin bimor	15	H6-08-III-0049-24
3	Teknologjia e prodhimit bimor	30	H6-08-III-0050-24
4	Vjelja e perimeve dhe bimëve të arave	15	H6-08-III-0051-24
5	Sipërmarrje dhe edukim karriere	5	H6-32-III-0013-24
6	Komunikimi dhe etika profesionale	6	H6-31-III-0014-24
7	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	9	H6-08-III-0047-24
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj;

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: K-H6-III-24

K - Kualifikim

H - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

6 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: H6-08-III-0048-24

H6 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

08 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

III - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0048 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit